



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**DHOMA E NOTERISE TIRANE**

Nr. 777 Rep.

Nr. 253 Kol.

Sot me date 19/02/2018 , para meje Fatmir LAÇEJ, noter ne qytetin e Tirane me zyre ne Rr. e Kavajes, Pall. 203 u paraqiten

Znj. Kristina QIRICI , bija e Rodolfit, lindur ne Kucove , me 10/06/19889 dhe banuese ne Tirane, me Leter Njoftimi ID me Nr. personal I95610070G

Znj. Eleni MORAITI BA IRAKTARI , shtetase greke , bija e Konstandinos , lindur ne Holargos - Papagu, Greqi , me 18/04/1989 dhe banuese ne Athine, me Karte Identiteti greke me Nr. AI961332

Te cilat kerkuan nga une noteri redaktimin e aktit te themelimit dhe statutit te qendres : BE THE CHANGE , te cilen une noteri e redaktoj ne baze te ligjit " Per Noterine dhe ligjit " Per organizatat Jofitimpruese"

**AKTI I THEMELIMI I QENDRES**

**" BE THE CHANGE "**

Ne mbështetje te legjislacionit civil shqiptar dlie kryesisht ne Ligjin nr. 8788 datë 7.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" dhe në Ligjin nr. 8789 datë 7.05.2001 "Për Rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurësë ne themelueset vendosem krijimin e Qendres, ne baze te Aktit te Themelimit, me kushtet e meposhtme:

**Neni 1**

**Lloji dhe emri**

Themelohet Qendra " **BE THE CHANGE** " ne shqip " **BE NDRYSHIMIN** " (më poshtë referuar "Qendra") qe eshte nje organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e paantarësi.

**Neni 2**

Qendra e ka selinë e saj ne adresen: Rr.Kavajes, Pall. SPEED , kati pare , Tirane . Me vendim të Bordit të Drejtorëve, Qendra mund të hapë degë të saj dhe të emërojë përfaqësues edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit. Qendra mund te hape llogari bankare ne Shqiperi dhe jashte saj.

**Neni 3**

**Identiteti i Themeluesve**

Themeluese te qendres jane :

Znj. Kristina QIRICI , bija e Rodolfit, lindur ne Kucove , me 10/06/19889 dhe banuese ne Tirane, me Leter Njoftimi ID me Nr. personal I95610070G

Znj. Eleni MORAITI BA IRAKTARI , shtetase greke , bija e Konstandinos , lindur ne Holargos - Papagu, Greqi , me 18/04/1989 dhe banuese ne Athine, me Karte Identiteti greke me Nr. AI961332



#### Neni 4

##### Qellimet dhe fusha e veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së qendrës është :

- Edukimi në fushën e psikoterapisë dhe keshillimit shkencor në fushën e aplikimit të teorisë psikoterapeutike në shëndetësi, në arsim dhe orientimin e mjekëve psikologë, punonjësve socialë, infermiereve të psikiatrive dhe të shkencave të tjera
- Studimi dhe hulumtimi i teorisë dhe praktikës së psikoterapeutikës dhe keshillimit
- Mbrojtja e moralit konsultativ –psikoterapeutik sipas përcaktimeve në kodin etik
- Ofrimi i shërbimeve shoqërore për grupet në nevojë përmes dhënies së psikoterapisë, trajnimit dhe /ose keshillimit
- Organizimi i kurseve të trajnimit e seminareve si dhe një qendër trajnimi dhe aktiviteteve edukative
- Bashkëpunimi me universitete dhe qendra shkencore në Shqipëri dhe bërja e studimeve të përbashkëta
- Ngritja dhe funksionimi i bibliotekës dhe veprimtaria editorial dhe printimi e shpërndarja e artikujve të ndryshëm si në reviste të posaçme ashtu edhe në rrugë elektronike
- Hartimi i projekteve dhe aplikimi në projekte të ndryshme për të mundësuar bashkëveprim, bashkëpunim, shkëmbim përvojash, midis komunitetit me institucione, donatorë, biznese, organizata, shoqata, individë të ndryshëm vendas ose të huaj etj.
- Bashkëpunimi me organizata simotra jashtë vendit dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to
- Organizimi i seminareve, konferencave, kongreseve kombëtare e ndërkombëtare

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Qendrës është një periudhë të pacaktuar.

#### Neni 6

##### Organet e Qendrës

Organet e qendrës janë:

Bordi Drejtoreve

Drejtori Ekzekutiv

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës është Bordi i Drejtoreve. Bordi përbëhet nga tre anëtarë, të cilët emërohen nga themeluesja e Qendrës. Bordi i Drejtoreve do të përbëhet nga:

**Kristina QIRICI, Eleni MORAITI BA IRAKTARI dhe Asimina CHIONI**

Drejtor ekzekutiv emërohet znj. Kristina QIRICI, me mandat 3 vjeçar me të drejtë perseritje

#### Neni 7

##### Drejtori Ekzekutiv

Drejtor Ekzekutiv e Qendrës do të jetë Znj. Kristina QIRICI. Drejtori do të përfaqësojë Qendrën në të gjitha aktivitetet e saj dhe ai ka të drejtën e firmës në llogaritë bankare në Shqipëri dhe jashtë saj.



Neni 7

Te ardhurat e Qendres

Te ardhurat e Qendres sigurohen nga:

Kontributet e themelueseve;

Te ardhura dhe financime nga donatore vendas dhe te huaj;

Te ardhura te siguruara nga veprimtaria e vete Qendres;

Kontributi fillestar i themeluesve eshte 50.000 (pesedhjetemije mijë) leke, te depozituara ne emer dhe llogari te qendres.

Ky Akt Themelimi u redaktua ne tre ekzemplare ne gjuhen shqipe , ju lexua me ze te larte dhe te qarte themelueseve , te cilat deklaruan se e kuptuan pasi ju perkthye prej meje noterit ne gjuhen angleze , znj Eleni MORAITI BA IRAKTARI dhe meqenese e gjeten ne perputhje me kerkesen dhe vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate pa verejtje para meje . Une noterit e vertetoj sipas ligjit.

THEMELUESET

Kristina QIRICI

*Kristina Qirici*

Eleni MORAITI BA IRAKTARI

*Eleni*

*Moraiti Bairaktari*

*[Signature]*

NOTERI

Fatmir LAÇEJ

*[Signature]*

